

**QKSS-ja: Serbia
ekzistencën e pavarësisë
së Kosovës e sheh
si kërcënim** FAQE 7



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



DEPUTETËT E ZGJEDHUR MË 9 SHKURT DO TË MBLIDHEN SOT (E SHTUNË)
PËR VAZHDIMIN E SEANCËS KONSTITUIVE TË LEGJISLATURËS SË NËNTË

BRITANIA DHE GJERMANIA U KËRKOJNË PARTIVE POLITIKE TË BASHKËPUNOJNË PËR FORMIMIN E INSTITUCIONEVE TË REJA

FAQE 4



Këtë të shtunë, në orën 12:00, deputetët e zgjedhur më 9 shkurt, do të mbledhen sërish për vazhdimin e seancës konstituive, pas dy dështimeve brenda kësaj jave. Ambasadorët e Britanisë së Madhe dhe të Gjermanisë në

Prishtinë u kanë bërë thirrje partive politike të bashkëpunojnë për tejkalimin e pengesave për formimin e institucioneve të reja. "Qytetarët meritojnë politikanë që e qesin Kosovën para politikave partiake. Prandaj, e

përsëris: Bashkëpunimi i mirëfilltë është urgjentisht i nevojshëm për të garantuar institucione funksionale dhe formim të shpejtë të një qeverie të qëndrueshme", ka porositur ambasadori gjerman Jorn Rohde

**A DUHET TË
JAPIN DORËHEQJE
ANËTARËT
E QEVERISË PAS
PËRFUNDIMIT
TË MANDATIT?** F. 3



**ORAV S'KA PËRGJIGJE
PËRFUNDIMTARE PËR
MASAT E BE-SË NDAJ
KOSOVËS: DISKUTIMET
BRENDA KËSHILLIT
VAZHDOJNË** F. 6



AKTUALE



**RUBIO: DO TË TËRHIQEMI NGA
MARRËVESHJA E PAQES RUSI-UKRAINË
NËSE S'KA PËRPARIM** F. 2

**MUSTAFA: NË VITIN 2017 E KAM
RESPEKTUAR KUSHTETUTËN, I KAM
LIRUAR NGA DETYRA MINISTRAT QË
ISHIN ZGJEDHUR DEPUTETË** F. 5

**PROFESOR AVNI SKEJA I DHURON
MBI 5 000 LIBRA UNIVERSITETIT
TË PRISHTINËS** F. 6

EKONOMI



**SHTRENJTIMI I RRYMËS, GRUPI
"ASNJË CENT MË SHUMË":
NËSE NUK KA REFLEKTIM DO TA
MASIVIZOJMË PROTESTËN** F. 8

**DISKUTOHET PËR GJENDJEN
AKTUALE TË TOKAVE BUJQËSORE** F. 8

SPORT



FINAL 4, I ZJARRTË NË BASKETBOLL F. 10

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Rubio: Do të tërhiqemi nga marrëveshja e paqes Rusi - Ukrainë nëse s'ka përparim

PARIS, 18 PRILL - Presidenti amerikan Donald Trump do të tërhiqet brenda ditësh nga përpjekjet për të ndërmjetësuar një marrëveshje të paqes në mes të Rusisë dhe Ukrainës nëse nuk ka sinjale të qarta se mund të arrihet një marrëveshje. Kështu deklaroi më 18 prill sekretari amerikan i Shtetit, Marco Rubio. “Ne nuk do ta vazhdojmë këtë përpjekje për javë apo muaj të tërë. Duhet të përcaktojmë shumë shpejt, dhe kur them shumë shpejt, flas për çështje ditësh, nëse kjo [arritja e një marrëveshjeje] është e realizueshme në javët e ardhshme. Nëse kjo ndodh, atëherë ne jemi brenda procesit. Nëse jo, atëherë ne kemi prioritetet të tjera ku duhet të përqendrohemi”, tha Rubio në Paris.

Kryediplomati Rubio tha se presidenti Trump është ende i interesuar për një marrëveshje, por është i gatshëm të tërhiqet nëse nuk ka sinjale të menjëhershme të përparimit. Rubio mori pjesë në bisedimet njëditore në Paris të mbajtura të enjten, ku ishin të pranishëm zyrtarët evropianë dhe ukrainas. Kryediplomati amerikan tha se diskutimet ishin konstruktive dhe rezultuan në një përmbledhje të hapave drejt paqes. Franca ishte mikpritëse e takimit dhe për herë të parë zyrtarët e lartë amerikanë, ukrainas dhe evropianë u takuan së bashku për të diskutuar për përfundimin e luftës. Rubio tha të premten se ai shpreson që evropianët do të mbeten të angazhuar në bisedimet e udhëhequra nga



ShBA-ja drejt një armëpushimi në Ukrainë. “Ne do të dëshironim që ata të mbeten të angazhuar... Mendoj se Mbretëria e Bashkuar, Franca dhe Gjermania mund të na

ndihmojnë që ta çojmë këtë çështje drejt një zgjidhjeje. Mendoj se ata ishin shumë ndihmues dhe shumë konstruktivë në idetë e tyre”, tha Rubio për gazetarët, teksa u

largua nga Parisi pas takimit me zyrtarët evropianë. Që kur mori mandatin e presidentit në janar, administrata e Trumpit ka zhvilluar disa raunde takimesh me Rusinë dhe Ukrainën për të arritur një armëpushim në luftën që nisi në shkurt të vitit 2022 dhe deklaratat e Rubios vënë në pah pakënaqësitë në rritje të ShBA-së lidhur me mungesën e përparimit drejt dhënies fund të luftës. Moska ka refuzuar ta pranojë propozimin e armëpushimit të paraqitur nga ShBA-ja, të cilin e ka pranuar Ukraina. Moska ka vendosur kushte, duke kërkuar që Ukraina t'i ndalë përpjekjet për mobilizim dhe që Perëndimi t'i ndalë dërgesat me armë për Kievin. Por, këto kërkesa janë refuzuar nga Ukraina.

Gjermania kërkon punëtorë ndërtimi

BERLIN, 18 PRILL - Marrëveshja e koalicionit CDU/CSU dhe SPD që synon ta qeverisë Gjermaninë për ta përgjysmuar kontingjentin e forcave të punës nga vendet e Ballkanit Perëndimor është kritikuar ashpër nga industria vendase e ndërtimit, e cila ankohet se ka mangësi të mëdha në këtë drejtim. Vendimi, për ta përgjysmuar kontingjentin e forcave të punës nga rajoni i Ballkanit Perëndimor, është “befasues dhe i dëmshëm për degën e ndërtimit”, tha për gazetatat “Stuttgarter Zeitung” dhe

“Stuttgarter Nachrichten” Tim-Oliver Muller, drejtor i përgjithshëm i Shoqatës Qendrore të Industrisë gjermane të Ndërtimit. Ai iu referua projekteve të planifikuara për infrastrukturën, “që parashikojnë nevoja në rritje për forca pune”. Një pjesë e konsiderueshme e të punësuarve të huajnë sektorin e ndërtimit vjen nga vendet e ish-Jugosllavisë, tha Muller, duke shtuar: “Zvogëlimi i kontingjentit të rregullores për Ballkanin Perëndimor në maksimumi 25 000 forca pune e prek rëndë ekonominë e

ndërtimit”. Në marrëveshjen e koalicionit theksohet se emigracioni i rregullt në Gjermaninë kuadër të ashtuquajturës Rregullorja e Ballkanit Perëndimor do të kufizohet me 25 000 persona në vit. Aktualisht bazuar në këtë rregullore numri i forcave të punës që tërhiqen në vit nga këto vende është rreth 50 000. Ky kontingjent vjen me kushte të thjeshtuara për dhënien e vizës dhe lejen e punës në Gjermani. Njohja e kualifikimit profesional në Gjermani nuk është kusht.



Kina: Nuk u kemi dhënë armë vdekjeprurëse palëve në luftën në Ukrainë



PEKIN, 18 PRILL - Pekini ka mohuar se i ka dhënë armë vdekjeprurëse ndonjëres palë në luftën në Ukrainë, pasi presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky pretendoi se ka “informacione” se Kina po e furnizon me armë Rusinë. “Pala kineze asnjëherë nuk ka ofruar armë vdekjeprurëse për ndonjërin palë në konflikt dhe në mënyrë të rreptë kontrollon mjetet me përdorim të dyfishtë”, tha zëdhënësi i Ministrisë së Jashtme kineze, Lin Jian, më 18

prill. Zelensky nuk dha hollësi për akuzat e tij ndaj Kinës, por vetëm tha se Kievi është “i gatshëm” të bisedojë për këto pretendime. Javën e kaluar presidenti ukrainas tha se Kievi e di se të paktën 155 shtetas kinezë janë dislokuar për ta ndihmuar Moskën në luftën kundër Ukrainës dhe pretendoi se ushtria ukrainase ka kapur dy ushtarë kinezë në rajonin lindor të Donjeckut. Pekini tha të premten se

“qëndrimi ynë ndaj çështjes së Ukrainës është konsistent dhe i qartë”. “Ne vazhdimisht kemi bërë përpjekje për ndaljen e armiqësive dhe për bisedime të paqes”, tha Lin. Kina e ka paraqitur veten si palë neutrale lidhur me luftën trevjeçare në Ukrainë pavarësisht prej kritikave të qeverive perëndimore se lidhjet e saj të ngushta me Rusinë i kanë dhënë Moskës ndihmë të rëndësishme ekonomike dhe diplomatike.

Sekretari i Mbrojtjes së ShBA-së i kërkon Francës të marrë rol udhëheqës në mbrojtje: Risni shpenzimet ushtarake

Uashington, 18 prill - Sekretari amerikan i Mbrojtjes i ShBA-së, Pete Hegseth, i kërkoi Francës t'i rrisë shpenzimet ushtarake dhe, në bashkëpunim me anëtarët e

tjerë të NATO-s, të marrë një rol udhëheqës në mbrojtjen e Evropës me armë konvencionale, tha një zëdhënësi i Pentagonit në një deklaratë.

Deklarata e zëdhënësit të Pentagonit, Sean Parnell, u bë publike pasi sekretari amerikan i Mbrojtjes, Pete Hegseth, u takua me homologun francez Sebastien

Lecorni në Uashington. Parnell tha se të dy ministrat diskutuan për përpjekjet për të arritur një “paqe të qëndrueshme” në Ukrainë, pa dhënë hollësi të mëtejshme.



A DUHET TË JAPIN DORËHEQJE ANËTARËT E QEVERISË PAS PËRFUNDIMIT TË MANDATIT?



PRISHTINË, 18 PRILL - Çështja e dorëheqjes së Albin Kurtit dhe anëtarëve të kabinetit qeverisës që janë zgjedhur deputetë është bërë mollë sherri në mes të Lëvizjes Vetëvendosje dhe partive të tjera shqiptare që kanë fituar ulëse në Kuvend në zgjedhjet e 9 shkurtit. Kurti pretendon se është kryeministër në dorëheqje që nga përfundimi i mandatit katërvjeçar të ekzekutivit, por partitë që ishin në opozitë mandatin e kaluar insistojnë që anëtarët e kabinetit qeverisës, që kanë dhënë dorëheqje, nuk mund ta vazhdojnë punën në ekzekutiv. Ndërkaq, njohësit e ligjeve thonë se kjo situatë është e re dhe me shumë paqartësi në Ligjin për Qeverinë.

Albin Kurti dhe kabineti qeveritar po pretendojnë se janë dorëhequr nga postet ekzekutive qysh më 23 mars. Atë ditë qeverisë i përfundoi mandati katërvjeçar. Dorëheqjen, përmes një letre, Kurti ia konfirmoi edhe kryetarit të deritanishëm të Kuvendit, Glauk Konjufca. Por, kjo letër u kontestua nga Partia Demokratike e Kosovës, Lidhja Demokratike dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës.

Duke mos e pranuar dorëheqjen në këtë formë, deputetët e këtyre partive votuan kundër verifikimit të mandateve të deputetëve dhe

rrjedhimisht pamundësuan konstituimin e Kuvendit më 15 prill. Mesditën e 17 prillit deputetët u mbledhën sërish për vazhdimin e seancës konstituive, por ajo sërish nuk prodhoi asnjë rezultat dhe u caktua vazhdimi i saj për 19 prill. Por, a mjafton kjo mënyrë e dorëheqjes së Kurtit dhe anëtarëve të tjerë të ekzekutivit?

Disa njohës të Kushtetutës besojnë se po, edhe pse thonë se Ligji për Qeverinë ka gabime dhe bie ndesh me Kushtetutën. “Nëse ligji nuk funksionon dhe efektet e ligjit janë shumë të rrezikshme për shoqërinë, atëherë nuk zbatohet ligji, por zgjidhet me praktikën [e kaluar] qeveritare. Çfarë ka ndodhur para këtij rasti, kryeministrit e mëparshëm, si kanë vepruar kur kanë qenë duke ushtruar detyrën? Do të thotë, kanë qenë deputetë, kanë votuar për deputetë dhe kanë qenë duke ushtruar detyrën [në Qeveri], ushtrues i detyrës nuk është detyrë [e plotë]”, thotë për “Radion Evropa e Lirë”, ish-gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese, Kadri Kryeziu.

Në Ligjin për Qeverinë, në nenin 26, thuhet se kur anëtari i një qeverie në detyrë zgjidhet deputet, duhet të japë dorëheqje nga posti i tij qeveritar para ditës së certifikimit të rezultateve. Pra,

para 27 marsit.

Në gjithë debatin për këtë situatë u përmend si gabim edhe fakti që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i ka certifikuar si deputetë Kurtin me ministria.

Por, a gaboi KQZ-ja këtu? Mazllum Baraliu, që më parë e ka udhëhequr këtë institucion, nuk e quan këtë gabim. Sipas tij, ky institucion s’ka kompetencë t’i kërkojë dorëheqje askujt në qeveri. “Nuk shkruan askund që [KQZ-ja] ka për detyrë që t’u thotë atyre të cilët kanë kandiduar për deputet, që të heqin dorë nga punët e tyre [në Qeveri]. Nuk është e rregulluar kjo punë dhe nuk është punë e KQZ-së kjo”, thotë ai për “Radion Evropa e Lirë”.

Çfarë tha Kurti për dorëheqjet?

Kryeministri në detyrë, Albin Kurti, njëherësh kreu i partisë fituese të zgjedhjeve të 9 shkurtit, Lëvizjes Vetëvendosje, tha se kërkesa e partive, që mandatin e kaluar ishin në opozitë, që ai të japë dorëheqje dhe të mos dalë në zyrë në Kryeministri, është e pakuptimtë.

“Më shumë se kaq nuk është e mundur të jepet dorëheqje. Më shumë se kaq do të ishte braktisje e institucionit, do të

ishte vakum institucional, papërgjegjësi politike dhe rrezikim i sigurisë kombëtare. Është kërkesë dhe insistim - thënë së buti - i pamatur për të lënë shtëpinë pa zot shtëpie”, tha ai gjatë mbledhjes së ekzekutivit më 16 prill.

Partitë e tjera insistojnë që postet e anëtarëve të qeverisë të zgjedhur deputetë, të udhëhiqen nga zëvendësit e tyre gjatë kësaj periudhe. Kurti tha se partia e tij është e interesuar të ecet para me formimin e institucioneve. Por, partitë që mandatin e kaluar ishin në opozitë, e kanë akuzuar LV-në se po e zvarrit këtë proces, duke argumentuar se partia fituese e zgjedhjeve nuk i ka 61 vota, aq sa kërkohen për zgjedhjen e kryetarit të Kuvendit, më pas edhe të formimit të Qeverisë së re të Kosovës.

Çfarë ndodh tani?

Pas mosmiratimit të raportit të Komisionit për Mandate, kryesuesi i seancës konstituive, Avni Dehari, iu drejtua presidentes Vjosa Osmani për të kërkuar sugjerime se si të vazhdohet. Osmani, brenda pak orësh, më 16 prill iu përgjigj, duke kërkuar vazhdimin e seancës konstituive brenda 48 orëve, siç parashihet në Rregulloren e Kuvendit. Sipas Osmanit, edhe aktgjykimet e

Kushtetueses i obligojnë deputetët “të jetësojnë e jo ta bllokojnë formimin e institucioneve, si dhe ta gjejnë rrugën përpara për konstituimin e Kuvendit”.

Partitë morën pjesë në seancë, por në të shkuan me qëndrime të njëjta. Në nisje të vazhimit të seancës, kryesuesi Avni Dehari nga LV-ja i ftoi në konsultime përfaqësuesit e partive politike. Pasi tha se nuk kishte konsensus se si të vazhdohet më tutje, ai e ndërpreu seancën dhe caktoi që ajo të vazhdojë të shtunën.

LV-ja tha se PDK-ja, LDK-ja dhe AAK-ja po e bllokojnë konstituimin e Kuvendit, por akuzë të njëjtë këto parti drejtuan nga partia e Kurtit. Ato argumentuan se LV-ja me shtyrjen e seancës për 48 orë po “blen kohë për pazare politike” pasi, sipas tyre, partia fituese e zgjedhjeve nuk e ka shumicën. Nëse të shtunën kalohet pika e parë e rendit të ditës, atëherë deputetët do të mund të betohen, më pas ta zgjedhin kryetarin e nënkryetarët dhe kështu ta përmbyllin konstituimin e legjislaturës së nëntë të Kuvendit. Vetëm pas kësaj do të fillonin afatet kushtetuese për formimin e Qeverisë së re të Kosovës. Asnjëra parti nuk ka fituar vota të mjaftueshme që të qeverisë e vetme, prandaj arritja e një koalicioni qeverisës duket opsion i pashmangshëm.



DEPUTETËT E ZGJEDHUR MË 9 SHKURT DO TË MBLIDHEN SOT (E SHTUNË)
PËR VAZHDIMIN E SEANCËS KONSTITUIVE TË LEGJISLATURËS SË NËNTË

BRITANIA DHE GJERMANIA U KËRKOJNË PARTIVE POLITIKE TË BASHKËPUNOJNË PËR FORMIMIN E INSTITUCIONEVE TË REJA

Këtë të shtunë, në orën 12:00, deputetët e zgjedhur më 9 shkurt, do të mblidhen sërish për vazhdimin e seancës konstituive, pas dy dështimeve brenda kësaj jave. Ambasadorët e Britanisë së Madhe dhe të Gjermanisë në Prishtinë u kanë bërë thirrje partive politike të bashkëpunojnë për tejkalimin e pengesave për formimin e institucioneve të reja. “Qytetarët meritojnë politikanë që e qesin Kosovën para politikave partiake. Prandaj, e përsëris: Bashkëpunimi i mirëfilltë është urgjentisht i nevojshëm për të garantuar institucione funksionale dhe formim të shpejtë të një qeverie të qëndrueshme”, ka porositur ambasadori gjerman Jorn Rohde

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 18 PRILL - Ambasadori i Britanisë së Madhe dhe ai i Gjermanisë në Prishtinë u kanë bërë thirrje partive politike të bashkëpunojnë për tejkalimin e pengesave për formimin e institucioneve të reja të Kosovës, pasi ato dështuan për herë të dytë radhazi ta konstituojnë Kuvendin e ri të enjten. Konstituimi i Kuvendit dështoi dy herë brenda kësaj jave për shkak të mosmarrëveshjeve procedurale mes partive politike që siguruan ulëse në zgjedhjet e 9 shkurtit. “Njerëzit kanë të drejtë të presin nga liderët e tyre politikë të punojnë së bashku për interes të vendit”, tha ambasadori britanik në Prishtinë, Jonathan Hargreaves, në një reagim në “Facebook”. Ai tha se Kosova ka nevojë “urgjente” për formimin e institucioneve të reja, pasi kanë kaluar më shumë se dy muaj nga mbajtja e zgjedhjeve. Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Lidhja Demokratike e

Kosovës (LDK) dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) këmbëngulin që anëtarët e qeverisë, të cilët janë zgjedhur deputetë, të japin dorëheqje, përndryshe nuk do ta votojnë raportin për verifikimin e mandateve të deputetëve, hap që duhet të kalohet për vazhdimin e konstituimit të Kuvendit dhe formimin e qeverisë së re. Por, kreu i Lëvizjes Vetëvendosje (LV) dhe kryeministri në detyrë, Albin Kurti, thekson se një akt i tillë formal është i panevojshëm për shkak se ekzekutivi është në detyrë, apo dorëheqje që nga 23 marsi. Ambasadori i Gjermanisë në Prishtinë, Jorn Rohde, tha se konstituimi i Kuvendit të Kosovës ka ngecur “për shkak të taktikave penguese”. “Qytetarët meritojnë politikanë që e qesin Kosovën para politikave partiake. Prandaj, e përsëris: Bashkëpunimi i mirëfilltë është urgjentisht i nevojshëm për të garantuar institucione funksionale dhe formim të shpejtë të një qeverie të

qëndrueshme”, shkroi Rohde në rrjetin social “Bluesky”. Nuk është e qartë nëse mosmarrëveshjet mes partive parlamentare do të zgjidhen para mbajtjes së vazhdimin të seancës së ndërprerë të enjten, e caktuar për të shtunën e 19 prillit. Kryeministri në detyrë dhe kryetari i Vetëvendosjes, Albin Kurti, nuk ka dhënë përgjigje të premtën nëse i kanë siguruar votat për miratimin e raportit për verifikimin e mandatit të deputetëve dhe zgjedhjen e kryetarit të Kuvendit, në vazhdimin e seancës konstituive që pritet të mbahet të shtunën. I pyetur nga gazetarët për këtë temë, Kurti është përgjigjur shkurt: “Ajo është nesër a po?”. Në seancën e së enjtes, e cila ishte vazhdimësi e seancës së ndërprerë të martën, kryesuesi i seancës konstituive, Avni Dehari, i ftoi në konsultime përfaqësuesit e partive politike dhe më pas tha se nuk kishte konsensus se si të vazhdohet tutje, duke njoftuar se seanca do të vazhdojë më 19 prill në

mesditë. PDK, LDK dhe AAK fajësuan LV-në se me ndërprerjen e seancave po tenton “të blejë kohë për pazare politike” pasi, sipas tyre, partia e Albin Kurtit nuk i ka votat për ta zgjedhur kryeparlamentarin e as qeverinë. Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka thënë se dorëheqjet formale të anëtarëve të qeverisë do ta zhblokonin konstituimin e Kuvendit. Vetëvendosje i fitoi zgjedhjet e 9 shkurtit, me rreth 42 për qind të votave, apo 48 ulëse nga 120 sa i ka Kuvendi i Kosovës. Por, asaj i nevojiten të paktën 61 ulëse për ta formuar qeverinë e re. Pas LV-së më së shumti vota fitoi PDK, me 24 ulëse, e pastaj LDK-ja me 20 sosh. Mandat kanë siguruar edhe deputetë nga koalicioni parazgjedhor midis Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dhe Nisma. Nga të gjitha këto parti opozitare, “vija të kuqe” për koalicion të mundshëm me LV-në nuk ka vendosur vetëm Fatmir Limaj, kreu i Nismës. Albulena Haxhiu nga LV-ja ka thënë se partia e saj dëshiron të gjejë zgjidhje për situatën e krijuar në Kuvend. Ajo ka thënë se edhe presidentja Osmani u ka kërkuar deputetëve që të gjejnë zgjidhje dhe, për këtë, sipas saj, “duhen konsultime”. “Ne duam ta korrigjojmë vendimin e gabuar të Kuvendit, por duhet të shohim se si është mënyra për ta korrigjuar atë

vendim”, ka thënë ajo duke iu referuar mosmiratimit të raportit të Komisionit për Verifikimin e Mandateve. “Kemi vullnet që të propozojmë mënyra se si duhet shkuar tutje. A do të jetë një komision i ri apo komisioni paraprak të bëjë përgatitjen e raportit të ri. Mund të ketë dhe propozime të tjera”, ka deklaruar Haxhiu pas ndërprerjes së seancës konstituive. Kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, ka thënë se LV-ja nuk e ka shumicën dhe nuk është “as afër” arritjes së shumicës prandaj, sipas tij, po pengon mbarëvajtjen e seancën konstituive, për të blerë “kohë për pazare politike”. Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lumir Abdixhiku, e ka quajtur të padrejtë ndërprerjen e seancës konstituive të Kuvendit të Kosovës më 17 prill. Abdixhiku e quajti shkelje të rëndë dhe “praktikë të mbrapshtë” vendimin e kryesuesit të seancës konstituive, Avni Dehari, për ndërprerje të seancës konstituive. Abdixhiku tha se Dehari që, sipas tij, ka rastisur të jetë nga Lëvizja Vetëvendosje, veproi padrejtësisht pasi, sipas tij, kishte quorum për ta vazhduar votimin e raportit të Komisionit për Verifikim të Mandateve. Ndërkaq kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka thënë se politikat bllokuese, shantazhuese dhe uzurpuese janë kryefjala e Albin Kurtit.

MUSTAFA: NË VITIN 2017 E KAM RESPEKTUAR KUSHTETUTËN, I KAM LIRUAR NGA DETYRA MINISTRAT QË ISHIN ZGJEDHUR DEPUTETË

PRISHTINË, 18 PRILL - Ish-kryeministri i Kosovës, Isa Mustafa, ka ftuar kryeministrin në detyrë, Albin Kurti, t'i lirojë nga detyra ministrat që janë zgjedhur deputetë. Ai ka bërë me dije se duhet të ndiqet standardi që ka krijuar ai në vitin 2017.

Në një prononcim për gazetën "Nacionale", Mustafa ka treguar se në vitin 2017 kishte liruar nga detyra ministrat që kishin marrë mandatin e deputetit.

Ndonëse asokohe nuk kishte Ligj për Qeverinë, ai ka sqaruar se këtë vendim e kishte marrë duke u bazuar në dy parime kushtetuese. "Në vitin 2017 është vepruar mbi bazën e parimeve kushtetuese, të përmbajtura në nenet 70 dhe 72 të Kushtetutës. I pari përcakton se mandati i deputetit fillon në ditën e certifikimit, ndërkaq i dyti, mospërpuethshmërinë e mandatit të deputetit me pozitën ekzekutive. Nuk ka ekzistuar Ligji për Qeverinë. Duke e respektuar Kushtetutën, ministrat që janë zgjedhur deputetë i kam liruar me vendim individual, veç e veç nga pozita e ministrit dhe kam emëruar ministra të tjerë deri në

dorëzimin e mandatit qeverisës në ardhje", ka thënë Mustafa.

Ai ka thënë se në të njëjtën mënyrë duhet të veprojë edhe kryeministri në detyrë Albin Kurti. "Unë nuk kam qenë deputet, andaj nuk kam dhënë dorëheqje. Z. Kurti do të duhej t'i lirojë ministrat ekzistues, që kanë marrë mandat të deputetit ditën e certifikimit dhe t'i zëvendësojë. Meqenëse ai është certifikuar për deputet, do të duhej të kërkojë mendim nga Zyra Ligjore e Qeverisë dhe ajo e Kuvendit për mënyrën e dorëzimit të detyrës zëvendësit të tij. Në të ardhmen ky vakum ligjor do të duhej të rregullohej me ndryshim dhe plotësim të Ligjit mbi Qeverinë", ka vlerësuar Mustafa.

Ish-kryeministri ka vlerësuar se ministrat që janë zgjedhur deputetë dhe nuk kanë dhënë dorëheqje janë duke e shkelur Kushtetutën e Kosovës. Sipas tij, ata po bëjnë shkelje të aktit më të lartë juridik dhe politik të vendit që nga dita e certifikimit të rezultatit zgjedhor nga KQZ-ja. "Në bazë të leximit të Kushtetutës, anëtarët e qeverisë që janë zgjedhur deputetë, në ushtrimin e detyrës së tyre janë



në shkelje ligjore dhe kushtetuese që nga dita e certifikimit, jo nga dita kur iu verifikohet mandati", është shprehur Mustafa.

Ish-kryetari i LDK-së i ka ftuar deputetët e legjislaturës së nëntë që këtë çështje të adresojnë për shqyrtim në Gjykatën Kushtetuese. "Dhënia e dorëheqjes tani nuk e korrigjon retroaktivisht shkeljen. Kuvendi do të duhej të konstituohet, kurse shumica e deputetëve që me të drejtë po bëjnë vërejtje, këtë çështje ta procedojnë në Gjykatën Kushtetuese", ka thënë Mustafa.

Legjislatura e nëntë e Kuvendit të Kosovës nuk po arrin të konstituohet për faktin se kryeministri në detyrë, Albin Kurti, dhe ministrat e tij që janë zgjedhur deputetë, po refuzojnë të japin dorëheqje nga pozitat e tyre.

Deputetët e PDK-së, të LDK-së dhe të AAK-së nuk po e votojnë raportin e Komisionit për Verifikimin e Mandateve të Deputetëve pa dhënë dorëheqje Kurti dhe ministrat që janë zgjedhur deputetë. Sipas tyre, nëse raporti do të votohej, ata do të bënin shkelje kushtetuese.

ISH-DEPUTETI BERISHA: QEVERIA ME VOTAT E LISTËS SERBE, PROJEKTI MË I RREZIKSHËM PËR SHTETIN E KOSOVËS

PRISHTINË, 18 PRILL - Ish-deputeti i Kuvendit të Kosovës, Hisen Berisha, ka thënë se Lëvizja Vetëvendosje, e udhëhequr nga Albin Kurti, po tenton ta formojë qeverinë e re pa votat e partive shqiptare në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Sipas tij, LV-ja po përpaket të mbijetojë në pushtet përmes një formule të rrezikshme që përfshin deputetë të Listës Serbe dhe minoriteteve, duke u mbështetur në një marrëveshje të fshehtë që është përfolur nga vetë presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq dhe ministrja e Jashtme në detyrë, Donika Gërvalla - Schwarz. "Deklarimet publike të tyre, se katër deputetë të Listës Serbe do të 'rebelohen' për të votuar qeverinë Kurti 3, i japin vullë një procesi që e shndërron institucionin më të lartë ekzekutiv të Kosovës në produkt të një pazari politik me Beogradin dhe me kriminelin Milan Radoiqiq. Këtë e kisha paralajmëruar në deklaratimet e mia mediale... Parashikova që tre deputetë serbë do të votonin, duke hequr paralele me tre deputetët e Nismës që pritët të jenë pjesë e koalicionit qeverisës. Pra, qeveria që synohet të formohet nuk është më as produkt i vullnetit të votuesve



shqiptarë, as e ndonjë koalicioni të natyrshëm politik. Ai është projekt i më i rrezikshëm që i është bërë sovranitetit të Kosovës që nga shpallja e pavarësisë. Pra, një qeveri e mbështetur në katër deri gjashtë deputetë të Listës Serbe dhe disa minoritarë të tjerë, që më herët dy prej tyre janë cilësuar të instrumentalizuar nga strukturat e Beogradit", ka theksuar ai në "Facebook".

Berisha ka thënë se, sipas skenarit të paralajmëruar, marrëveshja është negociuar në dy nivele. "Në terren me Radoiqiqin, përmes emisarëve të dërguar brenda LV-së, dhe në planin strategjik me Beogradin, ku niveli më i lartë drejtues ka

rolin kyç. Kjo tregon se projekti për ta mbajtur Kurtin në pushtet është ndërkombëtarisht i ndërthurur me interesat serbe dhe, për fat të keq, me tolerancën e faktorëve perëndimorë evropianë. Për më tepër, ky skenar po mbështetet edhe në një keqinterpretim procedural për zgjedhjen e kryetarit të Kuvendit", ka theksuar ish-deputeti Berisha.

Ai ka shtuar se në mungesë të një kandidature të dytë nga partia e dytë fituese dhe pa rivotim, partia fituese - edhe nëse kandidati nuk është i saj, por i ndonjë partneri të koalicionit - ka të drejtën ta ofrojë kandidaturën. "Nëse nuk zgjidhet në raundin e parë, vendi

shkon në zgjedhje. Dhe kjo, për momentin, është shpresa për ta shpëtuar Kosovën nga një qeveri që po projektohet të formohet me votat e Listës Serbe. Nëse ky skenar realizohet, Kurti do të kthehet në kryeministër jo me përkrahjen e popullit, por si përfaqësues i interesave që më herët i ka quajtur armike të shtetit. Ai do të jetë i varur nga votat e Listës Serbe dhe i detyruar t'i zbatojë marrëveshjet e nënshkruara në vitin 2023, si planin franko-gjerman, marrëveshjen e Ohrit dhe statutin e Asociacionit - dokumente që i japin veriut autonomi të plotë në kuptimin politik, territorial, kulturor dhe të sigurisë. Pranimi i këtyre marrëveshjeve nuk ndodhi rastësisht. Që në shkurt të vitit 2023 Kurti e pranoi nenin 7 të planit franko-gjerman, që përmes konceptit të vetëmenaxhimit, hap rrugë për sovranitet paralel në veri", ka theksuar Berisha, duke shtuar se në tetor 2023 pranoi statutin e Asociacionit, ndërsa në mars në Ohër përmbylli kapitullin e dorëzimit politik me pranimin e detyrimeve nga marrëveshjet antikushtetuese, pa njohje reciproke.

"Kam paralajmëruar se aleatët

evropianë të Kurtit, të cilët e mbështesin në emër të stabilitetit, kanë interes që ai të mbetet në pushtet për ta zbatuar këtë projekt deri në fund. Edhe zgjedhjet në ShBA janë pjesë e kalkulimit të Kurtit & Co: nëse fitojnë liberalët (Biden-Harris), implementimi do të ndodhë në vitin 2025; nëse fitojnë konservatorët (Trump), do të tentohet zbatimi i përsheptuar. Por faktorë të brendshëm - si 'Banja '23', tërheqja nga 'Defender 23', krizat në Kuvend dhe tensionet në veri - e penguan implementimin, por jo pranimin e detyrimeve që rrjedhin nga këto marrëveshje", është shprehur Berisha.

Ai ka vazhduar se sot për të mbetur në pushtet, Kurti dhe përkrahësit e tij janë të gatshëm të pranojnë gjithçka, përfshirë edhe votat e Listës Serbe. "Kjo është fatura që paguhet për pushtetin e çdo kushti. Një fushatë që filloi me retorikë anti-serbe, po përfundon me pakt politik me Beogradin. Kjo është drama e një Kosove që po shitet copë-copë, në emër të stabilitetit, për interesa të jashtme dhe me çmimin e lartë të shuarjes së sovranitetit të saj kushtetues", ka deklaruar ish-deputeti Berisha.

Shqipëria dhe Kosova, hapa të përbashkët drejt BE-së

TIRANË, 18 PRILL - Në ambientet e Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme të Shqipërisë është zhvilluar një takim ndërmjet drejtorëve politikë të Ministrisë së Jashtme të Shqipërisë dhe asaj të Kosovës. Ky takim u përqendrua në çështjet e bashkëpunimit dypalësh, integritetit evropian dhe bashkëpunimit rajonal. Në nisje të takimit, ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme,

Igli Hasani, përshëndeti delegacionin nga Kosova, duke vlerësuar bashkëpunimin e ngushtë ndërmjet dy vendeve dhe mes institucioneve. Takimi mes delegacioneve ka vazhduar me një bashkëbisedim frytdhënës lidhur edhe me përcaktimin konkret të hapave e aktiviteteve në vijim, si në kontekstin e bashkëpunimit dypalësh dhe në atë rajonal e

shumëpalësh. Forcimi i subjektivitetit të Kosovës përmes njohjeve të reja dhe përforcimi i rolit të saj në strukturat rajonale ishte pjesë e diskutimeve mes delegacioneve. Pjesë e rëndësishme e bisedimeve ishte edhe vëmendja dhe koordinimi në raport me faktorin shqiptar në rajon.



PROFESOR AVNI SKEJA I DHURON MBI 5 000 LIBRA UNIVERSITETIT TË PRISHTINËS

EPOKA E RE

Qendresa RAMA

Prishtinë, 18 prill - Profesori për 45 vjet i Fakultetit Teknik dhe më pas Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike të Universitetit të Prishtinës, Avni Skeja, ka dëshmuar një herë më shumë se tërë jetën do të jetë në shërbim të universitetit numër një të vendit. Ai i ka dhuruar të gjithë librat e vet, më shumë se 5 000, për studentët dhe personelin akademik të UP-së, duke treguar se me pensionim nuk i ka dhënë fund angazhimit jetësor për bartjen e dijes te gjeneratat e reja. Për këtë gjest fisnik, profesori Skeja në një ceremoni solemne të pranim-dorëzimit të këtyre librave, është pritur nga rektori Arben Hajrullahu, bashkë me prorektorët Albana Berisha-Qehaja, Avni Hajdari, Majlinda Gjellaj e Rozafa Basha, strukturat udhëheqëse të njësive akademike dhe përfaqësuesit e Bibliotekës Qendrore Universitare. Duke shprehur dëshirën që



veprimin e profesorit Skeja ta ndjekin edhe të tjerët, pasi Universiteti i Prishtinës është i të gjithë qytetarëve të Kosovës, rektori Arben Hajrullahu e cilësoi dhurimin e librave si “rast shembull se çfarë mund e duhet të bëhet dhe në çfarë drejtimi mund të lëvizim si

vend, si shoqëri, si universitet”. Më tutje në fjalën e tij rektori Hajrullahu profesorin Skeja e vlerësoi mjeshtër, ndërsa deklaroi se të gjithë ata që kanë kontribuar për universitetin, na kanë sjellë deri këtu.

Profesori Avni Skeja tregoi se në koleksionin e librave të tij të dhuruar, të mbledhur gjatë tërë jetës dhe nga donacionet, ka libra për Fakultetin Juridik e Ekonomik, Departamentin e Gjuhës Angleze e Psikologjisë si dhe për Shkencat kompjuterike e politike.

Profesori Skeja pati një mesazh për studentët dhe personelin akademik të UP-së. Tha se “nëse dëshirojmë ta shohim vendin tonë duke përparuar, atëherë secili nga ne duhet të japë atë që mundet, qoftë një orë mësimi më shumë, një ide, një libër a një bashkëbisedim frymëzues me një student të ri”. Skeja vlerësoi lart punën dhe vizionin e rektorit Arben Hajrullahu, sidomos përkushtimin e tij për meritokraci: “Dua ta shpreh mirënjohjen time të veçantë për rektorin e Universitetit të Prishtinës, i cili po e udhëheq këtë institucion me vizion dhe integritet, duke u bazuar në parimin e meritokracisë. Një vlerë që frymëzon dhe kontribuon për zhvillimin e sinqertë akademik”, tha profesori Skeja. Librat e profesorit Skeja do të shkojnë për sistemim në Bibliotekën Qendrore Universitare dhe pastaj do t’u shpërndahen bibliotekave të njësive akademike të Universitetit të Prishtinës.

ORAV S’KA PËRGJIGJE PËRFUNDIMTARE PËR MASAT E BE-SË NDAJ KOSOVËS: DISKUTIMET BRENDË KËSHILLIT VAZHDOJNË



PRISHTINË, 18 PRILL - Ambasadori i BE-së në Kosovë, Aivo Orav, ka thënë se për masat ndëshkuese të BE-së ndaj Kosovës nuk ka “një përgjigje përfundimtare”. Ai përmendi rekomandimin e ish-përfaqësuesit të lartë të BE-së, Josep Borrell, për heqjen e tyre dhe tha se diskutimet brenda Këshillit Evropian vazhdojnë. “Kam frikë se nuk mund t’i jap një përgjigje përfundimtare kësaj pyetjeje. Siç e dini, ish-

përfaqësuesi i lartë i rekomandoi Këshillit në qershor 2024 heqjen e masave. Më pas, në dhjetor 2024, Këshilli në konkluzionet e tij për zgjerimin deklaroi se BE-ja gradualisht do t’i heqë masat paralelisht me hapat e mëtejshëm të Kosovës për t’i shpërshkallëzuar tensionet në veri. Diskutimet brenda Këshillit vazhdojnë dhe vendimi nëse masat do të hiqen, përfundimisht u takon 27 vendeve anëtare të BE-së,

pasi një vendim i tillë kërkon konsensus”, tha ai për “Kosovo Online”. Orav tha se përfaqësuesja e re e lartë për politikë të jashtme dhe siguri, Kaja Kallas, dëshiron që Kosova të përparojë në rrugën drejt BE-së. “Kusht thelbësor për rrugën drejt BE-së si për Kosovën ashtu edhe për Serbinë është normalizimi i marrëdhënieve dhe zbatimi i zotimeve të dialogut”, përsëriti ai thirrjet e Unionit për Kosovën e Serbinë.

Kurti dhuron gjak

PRISHTINË, 18 PRILL - Me rastin e shënimit të Ditës së Dëshmorëve të komunës së

Prishtinës, kryeministri në detyrë, Albin Kurti, dhuroi të premten gjak në aksionin

simbolik, të organizuar në sheshin “Zahir Pajaziti”. Kurti, po ashtu, bëri homazhe dhe

vendosi lule pranë shtatores së heroit Zahir Pajaziti në sheshin që mban emrin e tij.



Krijimi i institucioneve, Veton Berisha: Jam i gatshëm të votoj për të mirën e Kosovës

PRISHTINË, 18 PRILL - Kryetari i Partisë Liberale Egjiptiane, Veton Berisha, ka dalë me një deklaratë për formimin e institucioneve të dala nga zgjedhjet e 9 shkurtit. Berisha ka thënë se nuk është për bllokimin e proceseve, por se

mbështetja e tij “nuk është nënshtrim” e “heshtje përballë mangësive”. “Unë, si kryetar i Partisë Liberale Egjiptiane, kam qenë i qartë në deklaratimet e mia: Jam i gatshëm ta votoj për të mirën e Kosovës, komunitetit tim Egjiptian dhe të gjithë

qytetarët pa dallim! Nuk jam për bllokimin e proceseve që i shërbejnë qytetarëve, stabilitetit të vendit dhe zhvillimit institucional. Mbështetja ime nuk është nënshtrim, nuk është heshtje përballë mangësive. Është qëndrim i pjekur politik

që i vë interesat e qytetarëve mbi kalkulimet e ngushta të partive. Kemi nevojë për një klimë bashkëpunimi, jo për një kulturë përçarjeje. Për hapa përpara, jo për rrënim të njëri-tjetrit”, ka shkruar Berisha në “Facebook”.



QKSS-ja: SERBIA EKZISTENCËN E PAVARËSISË SË KOSOVËS E SHEH SI KËRCËNIM

PRISHTINË, 18 PRILL - Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) përmes një raporti ka treguar se doktrina kombëtare e sigurisë së Serbisë është shndërruar në një instrument për institucionalizimin e armiqësisë ndaj Kosovës, duke thelluar bashkëpunimin strategjik me Rusinë dhe Kinën, një zhvillim që ka potencialin t'i minojë interesat e BE-së dhe NATO-s në Ballkanin Perëndimor. Raporti me titull: “Si e sheh doktrina e sigurisë së Serbisë Kosovën, Perëndimin, Rusinë dhe Kinën?”, paraqet një analizë të Strategjisë Kombëtare të Sigurisë së Serbisë të miratuar në vitin 2021. Sipas gjetjeve të raportit, pas retorikës së “neutralitetit ushtarak”, Serbia është duke e ngulitur në mënyrë sistematike një narrativë anti-perëndimore dhe është duke e trajtuar shtetësinë e Kosovës si çështje sigurie për të justifikuar sjellje agresive. Autori Ramadan Ilazi ka thënë se “doktrina e sigurisë së Serbisë jo vetëm që e refuzon pavarësinë e Kosovës, por e portretizon ekzistencën e saj si kërcënim për sigurinë

kombëtare”. Gjithashtu, ai ka theksuar se “kjo doktrinë është një plan politik që i jep mbulesë strategjike ndërhyrjes së Serbisë në Kosovë me qëllim minimin e mbështetjes për pavarësinë e saj”. Në letër doktrina e pozicionon Serbinë si një shtet që balancon mes Lindjes dhe Perëndimit. Por studiuesit e QKSS-së kanë theksuar se kjo është një fasadë. Në realitet, Serbia është duke ndjekur një politikë me dy binarë: përfshihet në mënyrë selektive me Perëndimin për përfitime ekonomike dhe politike, ndërsa në të njëjtën kohë thellon aleancat ushtarake, ekonomike dhe ideologjike me fuqi autoritare si Kina dhe Rusia. “Gjetjet konfirmojnë se politika e sigurisë së Serbisë po harmonizohet gjithnjë e më shumë me Moskën dhe Pekinin në çështje strategjike thelbësore”, ka theksuar Mentor Vrajolli, drejtor ekzekutiv i QKSS-së. Sipas tij, ky afrim, i kombinuar me qëndrimin armiqësor ndaj Kosovës, paraqet sfidë për bashkëpunimin rajonal dhe integrimin euroatlantik të Ballkanit Perëndimor. Sipas raportit, ndër elementet më shqetësuese të kësaj



doktrine është përqafimi nga ana e Serbisë i konceptit të “Mbrotjes Totale” - një model që militarizon shoqërinë dhe e zbeh kufirin ndërmjet sektorit civil dhe atij ushtarak. Raporti ka paralajmëruar se kjo

qasje mund ta rrisë rrezikun për destabilitet në rajon, sidomos në një kontekst ku Serbia vazhdon ta portretizojë Perëndimin, veçanërisht NATO-n, BE-në dhe shoqërinë civile, si instrumente të

ndërhyrjes së huaj. “Perceptimi selektiv i kërcënimeve në këtë doktrinë, i cili injoron ekstremizmin e djathtë të brendshëm dhe njëkohësisht e portretizon Kosovën si burim problemesh, reflekton një botëkuptim të politizuar dhe të siguar nga qeveria serbe. Kjo narrativë nuk është e bazuar në fakte, por është e dizajnuar për qëllime të brendshme politike, për t'i justifikuar praktikatat autoritare dhe për të kërkuar dominim rajonal”, ka thënë Jeta Loshaj, hulumtuese në QKSS. Raporti i QKSS-së ka bërë thirrje për një reagim proaktiv nga aktorët perëndimorë, gjithashtu edhe nga vetë Kosova. Ai i ka kërkuar NATO-s dhe BE-së të ndjekin një qasje më të koordinuar dhe të qëndrueshme ndaj Serbisë, përfshirë mekanizma kushtëzues që lidhin mbështetjen financiare dhe politike me përmbushjen e standardeve demokratike dhe harmonizimin e politikës së jashtme me atë të BE-së. Gjithashtu, rekomandohet që Kosova ta forcojë qëndrimin e saj diplomatik dhe ta përmirësojë koordinimin me aleatët kryesorë, në mënyrë që të perceptohet si një aktor normativ në rajon.



DITA E DËSHMORËVE TË UÇK-SË NË PRISHTINË, OSMANI: DËSHMORËT JANË THEMELI I LIRISË SONË

PRISHTINË, 18 PRILL - Presidentja Vjosa Osmani, në Ditën e Dëshmorëve të UÇK-së të komunës së Prishtinës, vendosi të premtën kurorë me lule në nderim të dëshmorëve në varrezat në Velani. Me përlulësi dhe respekt të

thellë presidentja Osmani kujtoi kontributin e secilit dëshmor që ra për ta parë Kosovën të lirë, të pavarur dhe demokratike. “Dëshmorët janë themeli i lirisë sonë. Kujtimi për ta nuk është vetëm nderim, por zotim se do të punojmë çdo ditë

për një shtet të drejtë, të barabartë dhe dinjitoz, ashtu siç e ëndërruan ata”, ka theksuar presidentja Osmani. Ajo ka bërë me dije se kjo ditë na kujton vlerat për të cilat ranë dëshmorët tanë dhe se kujtimi për ta është i përhershëm.

Rama pret në takim Vasfije Krasniqin: Një grua që është bërë simbol i forcës dhe guximit

PRISHTINË, 18 PRILL - Kryetari i Prishtinës, Përparim Rama, ka pritur në takim Vasfije Krasniqin, një grua që është bërë simbol i forcës dhe guximit. “Si një nga të

mbijetuarat e dhunës seksuale gjatë luftës, ajo ka ngritur zërin për shumë të tjera që ende presin drejtësi. Prania e saj na rikujton se plagët e luftës nuk shërohen

pa të vërtetën dhe pa drejtësinë. Me historinë dhe qëndresën e saj, Vasfije na fton të mos harrojmë, por të kujtojmë, jo vetëm për të kaluarën, por për të

ardhmen që ndërtojmë bashkë”, ka thënë Rama. Ai ka theksuar se drejtësia dhe njohja e këtyre krimeve janë detyrë e përhershme e njerëzimit.



Prishtina organizon konferencën më të madhe të kriptovalutave në rajon

PRISHTINË, 18 PRILL - Në një kohë kur teknologjia blockchain po transformon financat, industrinë dhe mënyrën si funksionon bota digjitale, Prishtina po bëhet epiqendra e këtij zhvillimi në Ballkan. Më 10 dhe 11 maj 2025

kryeqyteti i Kosovës do ta mirëpresë edicionin e dytë të BlockTalk, konferencën më të madhe dhe më të rëndësishme për kriptovaluta dhe teknologji blockchain në rajon. Ajo që e bën këtë ngjarje veçanërisht historike është përfshirja e

Binance, kompania më e madhe në botë për tregtim kriptovalutash, e cila këtë vit është sponore zyrtare e konferencës. Përfaqësues të nivelit të lartë nga Binance do të marrin pjesë, përfshirë edhe figura

kyçe nga ekipi drejtues global. Kjo është hera e parë që Binance përfshihet në një konferencë të tillë në Kosovë, një tregues i drejtpërdrejtë i rëndësisë që vendi ynë ka fituar në hartën globale të kriptovalutave.



DISKUTOHET PËR GJENDJEN AKTUALE TË TOKAVE BUJQËSORE

PRISHTINË, 18 PRILL - Task Forca për Mbrojtjen e Tokës Bujqësore nga Ndërtimet e Paplanifikuara Urbane dhe Degradimin e saj ka mbajtur takimin e katërt, i cili është kryesuar nga sekretarja e përgjithshme e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Venera Çerkini, e ku pjesëmarrës ishin përfaqësues nga Zyra e Kryeministrit, si dhe ata nga institucionet e tjera qeveritare të cilat janë pjesë e kësaj Task Force. Gjatë këtij takimi pjesëmarrësit kanë diskutuar për gjendjen aktuale të tokave bujqësore në vendin tonë si dhe e kanë vazhduar koordinimin e aktiviteteve dhe harmonizimin e politikave sektoriale me qëllim të mbrojtjes së tokës bujqësore

nga urbanizmi i paplanifikuar dhe degradimi i saj. Me këtë rast, kryesuesja e këtij takimi, sekretarja e MBPZHR-së, Venera Çerkini, ka theksuar se toka bujqësore si resurs natyror i kufizor, i parinovueshem dhe e mirë me interes të përgjithshëm për Republikën e Kosovës ka mbrojtje të veçantë dhe duhet të bëhet përmirësimi i potencialit prodhues të saj dhe të shfrytëzohet për prodhimtari bujqësore, duke u bazuar në parimet e zhvillimit të qëndrueshëm, për të siguruar prosperitet ekonomik të vendit. “Gjatë këtij takimi kemi diskutuar edhe për përditësimin e aktiviteteve nga plani i veprimit të Task Forcës për Mbrojtjen e Tokës Bujqësore nga ndërtimet e



paplanifikuara urbane dhe degradimi i saj”, ka thënë sekretarja Çerkini. Ndër të tjera, ajo ka treguar se për t'i adresuar të gjitha sfidat që ndërlidhen me tokat bujqësore, hartimi dhe zbatimi i kornizës ligjore është esencial.

“Në kuadër të kësaj pune tashmë në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit, Hapësinor dhe Infrastrukturës-MMPHI është duke u hartuar Draftligji për Planifikim Hapësinor të Kosovës dhe në MBPZHR është duke u hartuar

Draftligji për Tokën Bujqësore”, ka thënë ajo.

Task Forca për Mbrojtjen e Tokës Bujqësore nga Ndërtimet e Paplanifikuara Urbane dhe Degradimin e saj u formua me vendim qeveritar në korrik të vitit 2021, me iniciativë të ministrit të Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Kjo Task Forcë përbëhet prej shtatë institucioneve: MBPZHR-ja, që është koordinatore, Zyra e Kryeministrit, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Ministria e Administrimit dhe Pushtetit Lokal, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, si dhe nga Asociacioni i Komunave të Kosovës.

SHTRENJTIMI I RRYMËS, GRUPI “ASNJË CENT MË SHUMË”: NËSE NUK KA REFLEKTIM DO TA MASIVIZOJMË PROTESTËN

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 18 PRILL - Përfaqësuesi i grupit “Asnjë Cent më Shumë”, Besnik Shabiu, ka bërë thirrje publike për qytetarët që të shtunë, në orën 12:00, të marrin pjesë në një protestë masive kundër rritjes së tarifës së energjisë elektrike.

Në një konferencë për medie, Besnik Shabiu ka deklaruar se protesta do të jetë një përgjigje e drejtpërdrejtë ndaj vendimit të Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE), të cilin e ka cilësuar “të padrejtë dhe jolegjitime”. “Aktiviteti i grupit ‘Asnjë Cent më Shumë’ nuk ka ndaluar



për asnjë moment. Vazhdimisht jemi duke u marrë me këtë çështje, deri në

momentin kur të pezullohet përfundimisht vendimi për shtrenjtimin e rrymës që

është marrë në mënyrë joligjore nga ana e ZRRE-së, i cili më nuk përfaqëson interesat e qytetarëve të Republikës së Kosovës. Do të vazhdojmë të jemi edhe më tutje të zëshëm deri në momentet e fundit, ku bashkë me qytetarët do ta fitojmë këtë proces. Ashtu siç kemi paralajmëruar, nesër do të jetë protesta e radhës, e cila do të fillojë nga ora 12:00. Zëri i qytetarëve është mirë të mos ndalet në asnjë moment. Nesër në të njëjtën kohë ka qëlluar të jetë edhe seanca konstituive e cila po dështon tash e disa herë, natyrisht prej këtij sheshi do t'u bëjmë thirrje gjithë deputetëve të Republikës së Kosovës që ta

shtyjnë përpara këtë proces. Në momentin e parë që konstituohet Kuvendi, atëherë të thirret menjëherë në komisionin për energji ZRRE-ja për raportim, dhe sa më parë ky vendim të pezullohet. Përveç kësaj, do të vazhdojmë aktivitetet e tjera. Nëse edhe pas ditës së nesërme prapë do të vazhdohet të mos ketë reflektim, natyrisht se do të jemi të detyruar që protestat t'i masivizojmë”, ka thënë ai. Ndërsa avokati Ardian Bajraktari ka njoftuar për hapat ligjorë që janë ndërmarrë ndaj vendimit të ZRRE-së, duke paralajmëruar edhe kërkesën për masë të përkohshme për ta ndaluar ekzekutimin e vendimit.

Rritet konsumi i energjisë elektrike në shkurt të këtij viti

PRISHTINË, 18 PRILL - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar “Statistikat e Energjisë” për muajin shkurt 2025 me të dhëna për prodhimin dhe konsumin e thëngjillit, prodhimin dhe konsumin e energjisë, importin dhe eksportin e

energjisë, si dhe importin dhe eksportin e energjentëve të tjerë. Gjatë muajit shkurt të vitit 2025 energjia elektrike bruto në dispozicion ishte 776.64 GWh, ndërsa konsumi i energjisë elektrike ishte 536.32 GWh, që paraqet një rritje prej

12,86 % krahasuar me muajin e njëjtë të vitit paraprak. Pjesëmarrja e energjisë elektrike alternative në kuadër të konsumit të përgjithshëm ishte 5,76 %. Ndërkaq, importi i energjisë elektrike në shkurt të vitit 2025 ishte 374.94 GWh, ndërsa

eksporti i energjisë elektrike në të njëjtën periudhë ishte 132.32 GWh (këtu përfshihen edhe sasitë e transmetimit). Prodhimi i thëngjillit ishte rreth 658.12 mijë tonë që paraqet një rritje prej 1,43 % krahasuar me muajin e njëjtë të vitit paraprak.



PSE KINA PO E SHFAQ MBIZOTËRIMIN E SAJ ME MINERALE TË RRALLA NË LUFTËN TREGTARE ME SHBA-në?



Ato kanë emra vështirë të shqiptueshëm; janë thelbësore për prodhimin modern dhe po zhvendosen gjithnjë e më në qendër të luftës tregtare mes Shteteve të Bashkuara dhe Kinës. Furnizimi global me këto minerale të rralla, një grup prej 17 elementeve thelbësore që gjenden gjithkund, nga bateritë e automjeteve elektrike e deri te teknologjia e rëndësishme e mbrojtjes kontrollohet kryesisht nga Kina. Pekini tani po kërkon ta përdorë këtë përparësi strategjike në përplasjet e vazhdueshme dhe tensionet tregtare me Uashingtonin. Duke u përgjigjur ndaj tarifave të vendosura së fundi nga Shtetet e Bashkuara, Kina i kufizoi shitjet në SHBA për shtatë elemente të rralla. Edhe pse nuk është ndalim i plotë, kjo masë u kërkon prodhuesve të aplikojnë për licenca eksporti në Qeverinë kineze. Shqetësimet po shtohen se kjo mund të çojë në rritje çmimesh dhe ndërprerje të furnizimit, gjë që mund të ndikojë veçanërisht në kompanitë amerikane të mbrojtjes. “Ajo që ishte nafta për shekullin e XX-të, janë mineralet e rralla për shekullin e XXI-të”, tha Sean McFate, profesor në Shkollën Maxwell të Universitetit Syracuse për Shtetësi dhe Çështje Publike. “Mikroçipat, teknologjia e gjelbër dhe informatika kuantike, të gjitha këto, kërkojnë minerale të rralla, dhe Kina i ka shumicën e tyre. Kjo

është çështje e sigurisë kombëtare që shkon përtej tregut të aksioneve”, shtoi ai. Kina kontrollon më shumë se dy të tretat e prodhimit global të elementeve të rralla dhe mbi 90 për qind të kapacitetit të përpunimit. Ajo gjithashtu ka në thelb një monopol mbi përpunimin e mineraleve të rënda të rralla, një nëngrup që përdoret në sektorin e mbrojtjes në SHBA për të prodhuar magnetet të fuqishme, që janë të nevojshme për avionë luftarakë, anije luftarake, raketa, tanke dhe laserë. Mbetet për t’u parë si do t’i zbatojë Kina këto kufizime të reja, por një raport nga Qendra për Studime Strategjike dhe Ndërkombëtare (CSIS) në Uashington paralajmëron se ato me gjasë do të shkaktojnë ndërprerje të eksporteve, derisa Pekini ta sjellë sistemin e licencimit, dhe do të shkaktojë ndërprerje të furnizimit për disa kompani amerikane, veçanërisht ato në sektorin e sigurisë kombëtare. “Shtetet e Bashkuara janë veçanërisht të cenueshme ndaj këtyre zinxhirëve të furnizimit”, thuhet në raportin e 14 Prillit. “Aktualisht, nuk ka ndarje të mineraleve të rënda të rralla në SHBA”.

Si po i kufizon Kina mineralet e rralla?

Kufizimet e reja të eksportit zbatohen për shtatë elemente të rralla, të mesme dhe të rënda: samarium, gadolinium,

terbium, disprosium, lutetium, skandium dhe itrium – të gjitha të rëndësishme në sektorin e mbrojtjes. Itriumi, për shembull, përdoret si mbështjellës për motorët e avionëve për t’i bërë ballë temperaturave të larta, për ta parandaluar shkrirjen e tyre gjatë fluturimit. Derisa Pentagoni dhe firmat amerikane kanë rezerva, besohet se ato nuk janë të mjaftueshme për ta përballuar ndonjë ndërprerje të zgjatur të furnizimit. Përveç ndalimit të vetë elementeve, Pekini ka vendosur gjithashtu 16 entitete amerikane – të gjitha përveç njërës janë në industrinë e mbrojtjes dhe hapësirës – në listën e tij të kontrollit të eksportit, duke ua kufizuar atyre pranimin e mallrave me përdorim të dyfishtë, përfshirë elementet e rralla. Dimitar Gueorguiev, profesor në Universitetin Syracuse, thotë se ai e sheh këtë lëvizje të fundit më shumë si një sinjal nga Pekini për “aftësinë e tij për t’i kufizuar këto eksporte, nëse lufta tregtare përshkallëzohet më shumë”. “Është e rëndësishme të kihet parasysh se shumica e importuesve kanë pasur këtë shqetësim prej kohësh dhe ka mundësi të jenë furnizuar për të paktën disa muaj”, tha ai. Megjithatë, këto masa dhe mundësia për t’i përshkallëzuar ato janë mjet i fuqishëm për Kinën. Përveç aftësisë për t’i ndalur furnizimet, mbizotërimi i tregut nga Pekini ia lejon atij gjithashtu t’i diktojë çmimet,

që do të thotë se mund t’i rrisë kostot për klientë të caktuar, ose t’i kufizojë furnizimet me minerale të rralla jashtë kontrollit të saj, duke mbajtur çmime të ulëta. Kjo u pa edhe në masa të mëparshme të zbatuara nga Kina. Në vitin 2023, Pekini kufizoi eksportet e galiumit dhe germaniumit, që përdoren në çipa, radarë dhe satelitë. Kjo u pasua nga një ndalim i plotë i eksportit të tyre në SHBA në dhjetor 2024. Prej atëherë, çmimet janë rritur ndjeshëm dhe tregu global është fragmentuar. Galiumi i blerë nga vendet perëndimore është dy deri në tre herë më i shtrenjtë se ai i blerë në Kinë, sipas Project Blue. Raporti i CSIS-it gjithashtu paralajmëron se e eksportit nga Kina paraqesin kërcënim të drejtpërdrejtë për gatishmërinë ushtarake të SHBA-së, duke shtuar shqetësimet e ngritura nga ligjvënësit dhe analistët se vendi po mbetet pas në prodhim në mbrojtje. “Edhe para kufizimeve të fundit, baza industriale e mbrojtjes në SHBA luftonte me kapacitet të kufizuar dhe nuk kishte aftësinë për të rritur prodhimin për të përmbushur kërkesat teknologjike të mbrojtjes”, thuhet në raport. Autorët e raportit citojnë një vlerësim – nga një zyrtar i Forcave Ajrore të SHBA-së në vitin 2022 – se Kina po siguron sisteme dhe pajisje të avancuara armësh pesë deri

në gjashtë herë më shpejt se Shtetet e Bashkuara.

Si mund të përgjigjet SHBA-ja?

Përballë trysnisë nga Kina, ekspertët thonë se SHBA-ja duhet të ndërmarrë politika për ta shtuar prodhimin vendës dhe të kërkojë burime të reja në vende të tjera. Qysh në vitet e ’80-ta, SHBA-ja ishte lider në prodhimin e elementeve të rralla, por rritja e çmimeve çoi në mbylljen e minierës kryesore, Mountain Pass, në Kaliforni në fillim të viteve 2000. Kjo minierë është rihapur më pas dhe administrata të njëpasnjëshme amerikane, përfshirë atë të presidentit Donald Trump gjatë mandatit të tij të parë, kanë ndarë të holla për nxjerrjen dhe përpunimin e elementeve të rralla. Por, ta zësh Kinën në garë për elemente të rralla dhe minerale të tjera të rralla, kërkon kohë dhe kushton shumë. Disa që punojnë në këtë sektor thonë gjithashtu se pjesë të tjera të tarifave të vendosura nga Trump mund të kenë ndikime të dëmshme anësore, duke e bërë të vështirë rritjen e shpejtë të prodhimit. Në podcastin “Rare Earth Exchanges”, sipërmarrësi i industrisë, Daniel O’Connor, tha se materialet e tarifuar, si çeliku dhe alumini, janë jetike në miniera dhe përpunim. “Mos vendosni tarifa për gjërat që na duhen për të ndërtuar infrastrukturën”, tha ai. SHBA-ja po kërkon gjithashtu të sigurojë furnizime jashtë vendit, pasi administrata Trump synon të ketë më shumë qasje te elemente të rralla dhe mineralet jetike në Grenlandë dhe Ukrainë, ku Kievi dhe Uashingtoni thuhet se janë afër një marrëveshjeje. Uashingtoni ka sponsorizuar gjithashtu miniera të reja në Brazil dhe Afrikën e Jugut, dhe po financon objektin e parë të madh për përpunimin e elementeve të rënda të rralla jashtë Kinës, në Teksas, megjithëse asaj do t’i duhen vite për të dhënë rezultate. Ndërkohë, pritet që Pekini të vazhdojë të përdorë elementet e rralla si mjet trysnie ndaj Uashingtonit. “Kjo është bërë pjesë e strategjisë së Pekinit kur përballlet me SHBA-në”, shkroi më 14 Prill Neil Shearing, ekonomist i grupit Capital Economics.

REL



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Sot zhvillohet ndeshja Malisheva - Llapi

Sot (e shtunë) nise java e 30 në Superligën e Kosovës në futboll me ndeshjen interesante në mes të Malishevës dhe Llapit. Malisheva vjen në këtë ndeshje nga humbja në

mesjavë me Ferizajn, ndërsa Llapi është në seri prej dy fitoreve rresht dhe duke ikur nga pozita e parafundit. Skuadra e Batatinës ka një seri pozitive të rezultateve me vetëm një humbje nga pesë të

fundit. Malisheva që e ka blinduar pozitën e tretë, nga tri ndeshjet e këtij sezoni kundër Llapit i ka dy fitore, derisa ndeshja e fundit ndërmjet dy ekipeve ka përfunduar pa fitues. Kjo

xhiro vazhdon të dielën me dy ndeshje të tjera. Nga ora 15:00 Suhareka është nikoqire e lideres, Dritës, ndërsa nga ora 20:00 në “Fadil Vokrri” luhet ndeshja Prishtina - Ferizaj. Të hënën zhvillohen dy

ndeshjet e tjera të kësaj jave. Gjilani e pret Dukagjinin, ndërsa Feronikeli, që tashmë edhe matematikisht ka rënë nga liga, do të luajë kundër Ballkanit. Të dyja këto sfida zhvillohen nga ora 15:00.

Final 4, i zjarrtë në basketboll



MITROVICE, 18 PRILL - Pas ndeshjeve emocionuese dhe dramatike të çerekfinaleve, është koha për gjysmëfinale të “play-off”-it të ProCredit Superligës. Gjysmëfinale të zjarrta që premtojnë spektakël në basketboll në parket dhe tribuna. Katërshja e madhe e basketbollit të Kosovës, Bashkimi, Trepça, Sigal Prishtina dhe Peja, duan të kualifikohen në finale, por edhe ta fitojnë trofeun më të rëndësishëm në basketbollin e Kosovës. Në gjysmëfinalen e parë ndeshen kampionia aktuale, Trepça, me skuadrën më të trofeshme në vend, Sigal Prishtinën. Mitrovicasit përfunduan garat e rregullta në pozitën e dytë, me

19 fitore e nëntë humbje, derisa prishtinasit në pozitën e tretë me 17 fitore e 11 humbje, kurse në çerekfinale eliminuan Vëllaznimin pas tri ndeshjeve. Në katër sfidat e zhvilluara në elitë këtë edicion, bardhekaltrit kanë tri fitore ndaj mitrovicasve që kanë një fitore ndaj prishtinasve. Këto dy skuadra u përballën edhe në gjysmëfinale të Kupës, ku “Xehetarët” ishin më të mirë nga dy takimet për të

kualifikuar në finale, e ku më pas fituan këtë trofe, ashtu si e kanë fituar edhe Superkupën. Bashkimi - Peja është një tjetër përballje e zjarrtë e gjysmëfinaleve të “play-off”-it. Prizrenasit përfunduan në pozitën e parë me 20 fitore e tetë humbje, ndërsa pejanët në vendin e pestë me 14 fitore e 14 humbje, kurse në çerekfinale eliminuan Golden Eagle Yllin pas tri ndeshjeve. Portokallezinjtë duan titullin e dytë në histori, pasi të parin dhe të vetmin e fituan më 2018, kurse verdhezinjtë të shtatin në histori, ndërsa herën e fundit e fituan më 2023. Në katër duelet e zhvilluara këtë edicion në elitë, prizrenasit kanë tri fitore ndaj pejanëve që kanë një fitore.

ORARI

Të shtunën takohen:
19:00 Trepça - Sigal Prishtina

Të dielën takohen:
19:00 Bashkimi - Peja

‘Ylli i javës’, Tusha: Synojmë titullin dhe Kupën

GJILAN, 18 PRILL - Çmimi “Ylli i javës” nga Federata e Futbollit e Kosovës dhe sponsori i Superligës, Albi Mall, i ka takuar futbollistit të FC Drita, Veton Tusha, i cili shënoi dy gola në fitoren 2-0 të Dritës në ndeshjen e radhës kampionale kundër FC Prishtina. “Pas ndeshjes në Kupë, që nga minutat e para nuk ishte ekipi

ynë siç jemi mësuar ta shohim. I jemi qasur ndeshjes kampionale me ritmin që e kemi gjithmonë, dhe për ndeshjen kampionale ishim me 100 % të potencialit të ekipit tonë. Atmosfera te FC Drita është e mrekullueshme; si lojtarët, stafi teknik, mjekët dhe ekonomët, kemi harmoni shumë të mirë në grup. Përveç

titullit kampion, kemi synim edhe fitimin e Kupës së Kosovës”, ka thënë Tusha. “Jam shumë i lumtur që jam shpallur Ylli i Javës dhe të gjitha meritat u takojnë bashkëlojtarëve dhe stafit të trajnerëve. Shpresoj se do t'i arrijmë synimet tona dhe nuk do të dorëzohemi deri në fund”, ka shtuar Tusha.



SHKURT

Xhaka, synim i Galatasarayt

Skuadra turke Galatasaray ka nisur përgatitjet për sezonin e ardhshëm. Me synimin për të marrë pjesë në Ligën e Kampionëve në sezonin 2025-2026, verdhekuqtë po punojnë për ta forcuar skuadrën. Galatasaray, i cili dëshiron të shtojë një emër të madh në mesfushë, ka shprehur interesim për Xhakën. Kërkesat e lojtarit shqiptar mund të plotësohen nga klubi, por Xhaka dëshiron të luajë në Ligën e Kampionëve dhe duhet patjetër që klubi i drejtuar nga Okan Buruk të kualifikohet atje. Mesfushori me përvojë, i cili luajti në 45 ndeshje këtë sezon, ka shënuar dy gola dhe ka bërë shtatë asistime.

Gjimshiti: Ndaj Milanit synojmë fitore

Kapiteni i Kombëtares së Shqipërisë, Berat Gjimshiti, është optimist se Atalanta do të sigurojë një vend në Ligën e Kampionëve. “Atalanta ka rifituar besimin”, shprehet Gjimshiti, i cili më pas ka paralajmëruar se synim i skuadrës është fitorja në përballje me Milanin. “Të dielën kundër Milanit nuk do të jetë përcaktues. Ne nuk bëjmë llogari, thjesht zbresim në fushë për të fituar, kjo është dëshira dhe objektivi ynë”, u shpreh Gjimshiti. Atalanta ndodhet në vendin e tretë në kuotën e 61 pikëve, dy pikë më shumë se Juventusi dhe plus katër në raport me Bolognan e vendit të pestë.

Kumbulla: Kam rilindur në Spanjë, nuk e di të ardhmen

Marash Kumbulla po përjeton një nga sezonet më të mira në karrierë gjatë huazimit të tij te Espanyoli në La Liga. Ish-mbrojtësi i Hellas Veronës, që ende ka kontratë te Roma, është një ndër më të mirët në kampionatin spanjoll dhe i gjashti për numrin e topave të larguar nga zona, duke treguar formë të shkëlqyer. Në një intervistë për “Corriere dello Sport”, ai ka folur për të tashmen dhe të ardhmen. E ardhmja e tij është ende e paqartë, pasi marrëveshja me klubin katalanas është vetëm një huazim i thjeshtë pa të drejtë blerjeje. “Nuk e di, nuk kam asnjë ide. Jam këtu në huazim deri në fund të sezonit dhe ndihem shumë mirë. Do të jenë klubet ato që do të vendosin”, u shpreh Kumbulla.

Hamiltoni: Na duhet kohë të shkojmë aty ku dëshirojmë

MARANELLO, 18 PRILL - Këtë fundjavë botërori i Formulës 1 spostohet në Arabinë Saudite, në pistën e Jeddahut. Makina Ferrari shpreson të rikthehet protagoniste në një pistë qytetase, aty ku vitet e fundit gjithnjë është

paraqitur mirë. Ai që karikon skuadrën italiane është shtatë herë kampioni i botës, Lewis Hamilton. Ai fitoi garën sprint në Kinë dhe më pas për “kokëkuqen” gjërat kanë qenë më së shumti një zhgënjim. I pyetur nëse

Ferrari është në krizë apo bota rreth tij po krijon një të tillë, ai sqaron: “Mendoj se është kjo e dyta. Nga njëra anë është e pritshme, ne po flasim për ekipin më të madh në historinë e Formula 1. Është kaq i veçantë”, ka thënë

Hamiltoni. “Ne duam ta shfrytëzojmë energjinë dhe pasionin që është në skuadër. Duhet ta mbrojmë ekipin, sepse ne jemi më shumë qendër të vëmendjes se çdo ekip tjetër. Nuk kam asnjë dyshim se do të arrijmë



atje ku duam. Duhet kohë”, ka shtuar Hamiltoni.

Messi: Natyrisht që mendoj për Botërorin e Gjashtë

MIAMI, 18 PRILL - Në pak më shumë se një vit, Lionel Messi mund të bëhet futbollisti i parë që do të luajë në gjashtë Kupa Botërore, përkrah rivalit të përjetshëm Cristiano Ronaldo. Ndërkohë, të dy po vazhdojnë garën e tyre për të arritur 1 000 gola profesionistë, me CR7 aktualisht përpara, ndonëse me një karrierë më të gjatë deri tani. Argjentinasi, kampioni botëror në fuqi dhe aktualisht tek Inter Miami, dha një intervistë për “Simplemente Futbol”, ku foli për mundësinë e pjesëmarrjes në edicionin e Botërorit 2026 në Kanada, Meksikë dhe ShBA. “Sigurisht që mendoj për Kupën e Botës dhe mundësinë për të qenë atje, por jetoj ditaditës. Duhet të jem i sinqertë me veten për të kuptuar nëse mund të jem apo jo. Më pëlqen ajo që bëj, jam rritur me një top dhe do të jetë gjithmonë kështu, përtej të qenit lojtar apo jo. Për aq kohë sa mundemi, më pëlqen”, ka thënë 37-vjeçari. Ai më pas zbuloi se që nga ardhja e tij në MLS, ka ndryshuar mënyrën e të luajturit. “Është një ligë shumë



fizike, ku ka shumë lojtarë të rinj që korrigojnë gabimet e tyre me trupin e tyre. Nuk duket kështu, por ka shumë vrapim dhe ka shumë ndeshje me përmbysje të vazhdueshme të frontit në minutat e fundit, dhe ka më shumë hapësira. Është një ligë që i lejonet dhe e forcojnë veten e tyre shumë mirë, ata do të nënshkruanin më shumë lojtarë, sepse ka shumë kufizime, por mund të rritet edhe më shumë, distancat janë më të gjata”, tha ai. Rivaliteti që u krijua me

Meksikën gjatë Kupës së Botës 2022 në Katar. “Nuk e di se çfarë ndodhi me meksikanët, që kur filloi kjo urrejtje. Unë jam ndier gjithmonë shumë i dashur nga njerëzit e tyre, por ata e vunë veten në një pozicion rivaliteti që realisht nuk ekziston. Por ishte më shumë një gol për të sesa për njerëzit, më shumë një dalje për stadiumin sesa për njerëzit, e tifozëve ishte ndeshja e vetme ku mund të ndieje se ishte vërtet shumë e ekuilibruar”, ka deklaruar Messi.

Aston Martini pritet të bëjë ofertën marramendëse për Verstappenin

HASELT, 18 PRILL - Një mal me para për marrëveshjen e shekullit. Shuma e cila mund ta jellë Max Verstappenin tek Aston Martini është vërtet astronomike. Holandezi, i cili duket se ka vendosur të largohet nga Red Bulli në fund të këtij sezoni, do ta gjente veten duke nënshkruar kontratën më të pasur në historinë e Formulës 1. Bëhet fjalë për 264 milionë euro për tre vitet e ardhshme (2026-2028). Mund të duket si fantazi, por është realitet për faktin e thjeshtë se ky megatransferim do të financohej nga fondi sovran i Arabisë Saudite. Ata kanë vendosur ta marrin pronësinë e



Aston Martinit, aktualisht në duart e Lawrence Stroll, i cili ka shprehur synimet për ta shitur atë. Paratë për arabët nuk janë problem. Interesimi saudit në botën e garave të Formula 1 ka shpërthyer vitet e fundit, pas marrëveshjes me Liberty Media

për ta organizuar garën në Jeddah. Fondi sovran zotëron tashmë 20 % të aksioneve të Aston Martin. Paga e Verstappenit pothuajse do të dyfishohej, nga 50 në 88 milionë euro në vit. Tek Aston Martini mbërriti më herët gjeniu i aerodinamikës Adrian Newey nga Red Bulli. Për të mos përmendur marrëveshjen me Hondan për furnizimin e njësive zyrtare të gjeneratës së ardhshme. Max do të ribashkohej me drejtorin teknik me të cilin punoi te Red Bulli dhe markën japoneze që ka kontribuar në të gjitha triumfet e tij.

SHKURT

Kastrioti mposht Vushtrrinë, Prishtina Trepçën

Janë luajtur të enjten dy ndeshje të javës së 27 të Superligës së Kosovës në hendboll në konkurrencë të meshkujve. Është kjo java e parafundit e stinorit të rregullt. Kastrioti i Ferizajt fitoi 47:22 ndaj Vushtrrisë dhe u kthye në vendin e dytë në tabelë. Kastrioti i ka 43 pikë, një më shumë se Besa Famgas që renditet e treta. Rahoveci udhëheq me 53 pikë, ndërsa Prishtina renditet e katërta me 27 pikë. Këto katër skuadra do të garojnë në plejof për titull të kampionit. Yassine Henahen dhe Agon Selmani i shënuan nga nëntë gola për Kastriotin ndaj Vushtrrisë. Amir Fazliu ishte më efikas te Vushtrria me gjashtë gola. Egzon Ademi e Adnan Musa i realizuan nga pesë. Vushtrria është e pesta me 16 pikë. Po të enjten Prishtina fitoi 41:33 ndaj Trepçës. Oltion Beshiri me dhjetë dhe Albi Gjuka me nëntë gola, ishin më efikas te Prishtina. Ardi Halili i shënoi nëntë gola për mitrovicasit, kurse Arbër Neziri tetë. Trepça është e shtata me 12 pikë. Do të përfundojë kampionatin në këtë pozitë dhe do ta kërkojë mbetjen në elitë përmes barazhit.

Ancelotti largohet nga Reali pas finales në Kupën e Mbretit

Trajneri italian Carlo Ancelotti ka marrë vendimin për t'i dhënë fund aventurës në krye të Real Madridit pas finales së Kupës së Mbretit kundër Barcelonës, e cila do të luhet më 26 prill. Sipas burimeve pranë klubit, largimi i Ancelottit vjen pas një sërë zhvillimesh të brendshme, përfshirë një ultimatum të vendosur nga presidenti Florentino Perez, i cili kishte kushtëzuar qëndrimin e tij me kualifikimin në gjysmëfinalet e Ligës së Kampioneve, objektivi që nuk u realizua. Ancelotti, i cili u rikthye në stolin e “Los Blancos” në vitin 2021, largohet pas katër vjetësh në krye të skuadrës madrilene. Gjatë kësaj periudhe ai ka udhëhequr klubin drejt sukseseve të rëndësishme si në arenën vendase, po ashtu edhe në atë ndërkombëtare. Destinacioni i radhës për teknikun italian pritet të jetë drejtimi i Kombëtares së Brazilit, një lëvizje që është përfolur prej kohësh dhe që tashmë duket se po konkretizohet.

De Bruyne kërkohet edhe nga dy klube amerikane

Pas disa vjetësh te Manchester City, Kevin De Bruyne do të largohet, në kërkim të një aventure të re. Disa epike kërkohen shërbimet e belgut, por ende nuk ka diçka konkrete. Sipas asaj që raportohet nga “The Athletic”, në gjurmët e tij janë edhe dy klube të tjera amerikane. Kalimi te New York City është i mundshëm, ndërsa kohën e fundit përflitet për një transferim te DC United. “Të jem i sinqertë, nuk e di. Mund të ketë mundësi të qëndroj në Angli. Më duhet ende të flas me klubet dhe me familjen time”, ka thënë De Bruyne.

Befason tenistja spanjolle, pensionohet në moshë të re

Tenistja spanjolle Sara Sorribes Tormo tronditi botën e tenisit dhe vendosi t'i japë fund karrierës, edhe pse është vetëm 28-vjeçare. Sorribes njoftoi se do të bënte një pushim nga karriera

dhe për këtë shkroi në rrjetet sociale. “Sara e gëzuar dhe e lumtur që shihni jashtë fushës është larg realitetit të gjithçkaje që mbaj brenda”, ka zbuluar fillimisht ajo në “Instagram”.

“Kam humbur dëshirën për të stërvitur, për të përparuar dhe për të shkuar në turne. Vendosa të gjej kohë për veten time, për kokën dhe trupin tim. Kam disa kohë që vuaj në fushë”, ka

përfunduar spanjollja. Ajo thotë se një periudhë e vështirë është pas dhe se po vendos të pushojë nga karriera për shkak të stresit. Meqë ra fjala, Sorribes fitoi medaljen e bronzitë në garën e

çifteve në Lojërat Olimpike në Paris verën e kaluar, ku konkurroi me Cristina Bucs. Ajo ka deklaruar se nuk e di nëse ndërprerja e karrierës do të jetë e përhershme apo e përkohshme.



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA



Në bazë të nenit 57 të Ligjit Nr. 04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shendetësor, Nenit 8 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, si dhe nenin 5 dhe 7 i Udhëzimit Administrativ (MFPT) Nr. 01/2024 për Rregullimin e procedurave për themelimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik, Oda e Mjekëve të Kosovës shpall këtë:

KONKURS
Për plotësimin e vendit të punës

Titulli i vendit të punës: Udhëheqës/e i/e Zyrës Ligjore (1) pozitë
I raporton: Sekretarit të Përgjithshëm të OMK-së
Niveli i pagës: 7.76
Orët e Punës: 40 orë në javë
Kohëzgjatja e Kontratës: Kohë të pacaktuar
Vendi Punës: "Instituti A" QKUK, 10 000 Prishtinë

Detyrat e përgjithshme:

- Koordinon, menaxhon dhe mbikëqyr punën e Zyres Ligjore të OMK-së;
- Ofron udhëzime dhe këshilla profesionale në kuadër të Zyres Ligjore;
- Harton dhe zhvillon legjislacion, akte normative si dhe akte të tjera juridike, kontrata, marrëveshje të cilat dalin nga fushëveprimtaria e OMK-së në bazë të procedurave të përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi;
- Monitoron ligjet e zbatueshme të Republikës së Kosovës;
- Siguron që përmbajtja dhe forma e aktit normativ të përgatitura nga ZL të jetë sa më e saktë, si nga aspekti gjuhësor dhe teknik;
- Drafton opinione/memorandume/përmbledhje ligjore në çështje të ndryshme ligjore kërkuar nga organet e ndryshme me aktivitetet e Odës;
- Bën hulumtime dhe analiza të ndërlidhura me ligjet dhe aktet nënligjore brenda fushës së përgjegjësisë dhe jep rekomandime, këshilla, udhëzime për stafin dhe organet e OMK-së;
- Harton raportet e punës të Zyres Ligjore;
- Kryen edhe detyra të tjera sipas kërkesave të Sekretarit të Përgjithshëm në pajtueshmëri me ligjet dhe rregulloret e zbatueshme si dhe aktet e brendshme të OMK-së.

Kualifikimet:

- Të jetë i diplomuar në Fakultetin Juridik, apo të avancuar (studime master);
- 2 (dy) vite përvojë pune menaxheriale;
- Preferohen kurse dhe trajnime gjatë karrierës profesionale;

Aftësitë:

- Plotëson kushtet e përgjithshme të parapara me Ligj dhe Statut të OMK-së;
- Njohja e gjuhës angleze e obligueshme;
- Njohja e punës me kompjuter në softuer të nevojshëm për kryerjen e punëve;
- Të ketë shkathësi në përcaktimin dhe arritjen e objektivave strategjike të institucionit, aftësi të larta organizative dhe drejtuese, aftësi të shkëlqyeshme të komunikimit dhe negociimit, aftësi të dëshmuara për analizën e gjendjes dhe ofrimin e opsioneve, njohuri të standardeve të integritetit, ndershmërisë dhe drejtësisë;

Mënyra e aplikimit;

Aplikimi bëhet vetëm në mënyrë elektronike në adresën: info@omk-rks.org

Kandidatët të cilët konkurojnë duhet të shënojnë saktë adresën, numrin e telefonit kontaktues si dhe email adresën. Vetëm kandidatët që plotësojnë kriteret e konkursit do të ftohen në procedura të tjera të rekrutimit.

Dokumentet që duhet të bashkangjiten:

- Aplikacioni i OMK-së [Formulari i aplikimit](#)
- Kopjen e letërnjoftimit;
- Kopjen e diplomës të kërkuar me konkurs të lëshuar nga institucionet arsimore të Republikës së Kosovës. Nëse diploma është fituar jashtë vendit, vërtetimin e nostrifikimit të diplomës së fituar apo aktin që dëshmon se diploma e fituar është në procedurë të nostrifikimit, me kusht që nostrifikimi i diplomës të dorëzohet deri në momentin e nënshkrimit të aktit për emërim në pozitë;
- Kopjet e dëshmisë së punësimit (vërtetim/kontratë) të lëshuar nga institucioni përkatës i punësimit për përvojën e punës, që përcakton pozitën e punës si dhe kohëzgjatjen e angazhimit në atë pozitë. Dëshmisë e punësimit jashtë institucioneve publike duhet të mbështetë së paku njëra nga dëshmitë si në vijim: pasqyra e pagesave në fondin e kursimeve pensionale apo pasqyra e pagesave të obligimeve tatimore në përputhje me legjislacionin tatimor për të ardhurat personal.
- Dëshmitë e trajnimeve profesionale të ndjekura apo trajnimeve që aplikuesi i ka realizuar në cilësinë e trajnuesit.

Kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit:

- Konkursi publik është i hapur deri më 05.05.2025;
- Faza e verifikimit paraprak të aplikacioneve deri në 7 ditë;
- Faza e testit me shkrim 10 ditë pas fazës së verifikimit;
- Faza e intervistës deri në 7 ditë pas shpalljes së rezultateve të testit me shkrim;
- Publikimi i rezultateve deri 5 ditë pas vlerësimit të intervistës.

Shënim: Aplikacionet që arrijnë pas afatit të përcaktuar në konkurs dhe ato të pakompletuara me dokumentacionin përkatës nuk do të shqyrtohen.

Mënyra e vlerësimit dhe kriteret e poentimit;

- Vlerësimi i kandidatëve zhvillohet nëpërmjet testimit me shkrim dhe intervistimit (testim me gojë);
- Testi me shkrim - maksimumi 70 pikë;
- Intervista - maksimumi 20 pikë
- Jetëshkrimi - maksimumi 10 pikë.

Oda e Mjekëve të Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë burrë apo grua dhe nga të gjitha komunitetet në Republikën e Kosovës.

Shpallja është e hapur që nga data 18.04.2025 deri më 05.05.2025 në ora 23:59.

Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në nr. tel.: 049/872-300 apo 038/544-872.



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

Na osnovu člana 57. Zakona br. 04/L-150 o komorama zdravstvenih radnika, člana 8. Zakona br. 03/L-212 o radu, kao i člana 5. i 7. Administrativnog uputstva (MFRT) br. 01/2024. o regulisanju postupaka za osnivanje radnog odnosa u javnom sektoru, Lekarska komora Kosova raspisuje ovaj:

KONKURS
o popunjavanu radnog mesta

Naslov radnog mesta: Rukovodilac/teljka Pravne kancelarije, jedno (1) radno mesto
Izveštava: Generalni sekretar Lekarske komore Kosova
Nivo plate: 7.76
Radno vreme: 40 sati nedeljno
Trajanje ugovora: Na neodređeno vreme
Radno mesto: "Instituti A" KUCK, 10 000 Prishtina

Opšte dužnosti:

- Koordira, upravlja i nadgleda rad Pravne kancelarije LKK-a;
- Daje stručna uputstva i savete u okviru Pravne kancelarije;
- Izrađuje i sprovodi zakonodavstvo, normative akte i druge pravne akte, ugovore, sporazume koji proističu iz delokruga LKK-a, na osnovu postupaka koji su utvrđeni u skladu sa važećim zakonodavstvom;
- Prati primenjive zakone Republike Kosovo;
- Obezbeđuje da sadržaj i forma normativnog akta koje priprema PK budu što tačniji, kako sa jezičkog tako i sa tehničkog aspekta;
- Izrađuje pravna mišljenja/memorandume/sažetke o različitim pravnim pitanjima koje traže različiti organi u vezi sa aktivnostima Komore;
- Sprovodi istraživanja i analize u vezi sa zakonima i podzakonskim aktima u okviru delokruga i daje preporuke, savete i uputstva osoblju i organima LKK-a;
- Izrađuje izveštaje o radu Pravne kancelarije;
- Obavlja i druge dužnosti na zahtev Generalnog sekretara u skladu sa primenljivim zakonima i uredbama kao i unutrašnjim aktima LKK-a.

Kvalifikacije:

- Da je diplomiran na Pravnom fakultetu ili naprednim studijama (master studije);
- 2 (dve) godine radnog isustva na rukovodećim funkcijama;
- Poželjni su kursevi i obuke tokom stručne karijere;

Sposobnosti:

- Da ispunjava i opšte uslove predviđene Zakonom i Statutom LKK-a;
- Poznavanje engleskog jezika je obavezno;
- Poznavanje rada na računaru sa potrebnim softverom za obavljanje poslova.
- Da poseduje veštine u postavljanju i ostvarivanju strateških ciljeva institucije, visoke organizacione i liderske veštine, odlične komunikacione i pregovaračke veštine, dokazane veštine analize situacije i nudenja opcija, poznavanje standarda integriteta, poštenja i pravde;

Način apliciranja:

Apliciranje se vrši samo elektronskim putem na adresu: info@omk-rks.org

Kandidati koji konkurišu moraju tačno napisati adresu, broj kontakt telefona kao i email adresu. Samo kandidati koji ispunjavaju kriterijume konkursa biće pozvani na dalje postupke zapošljavanja.

Dokumenti koji se trebaju priložiti:

- Aplikacija LKK-a [Formular aplikiranja](#)
- Kopija lične karte;
- Kopija diplome zahtevane konkursom izdate od obrazovnih institucija Republike Kosova. Ako je diploma stečena izvan zemlje, potvrda o nostrifikaciji stečene diplome ili akt koji dokazuje da je stečena diploma u postupku nostrifikacije, pod uslovom da se nostrifikacija diplome podnosi do momenta potpisivanja akta za imenovanje na poziciji;
- Kopije dokaza o zaposlenju (potvrda/ugovor) izdate od odgovarajuće institucije za zapošljavanje za radno iskustvo, koje utvrđuju radnu poziciju kao i trajanje angažovanja na toj poziciji. Dokaz o zaposlenju van javnih institucija mora biti potkrepljen najmanje jednim od dokaza kao u nastavku: izveštaj plaćanja u penzijski štedni fond ili izveštaj plaćanja poreskih obaveza u skladu sa zakonodavstvom o porezu na lične prihode.
- Dokaz o pohađanim stručnim obukama ili obukama koje je aplikant realizovao u svojstvu trenera.

Približni kalendar postupka zapošljavanja:

- Javni konkurs je otvoren do dana 05.05.2025;
- Faza prethodne verifikacije aplikacija do 7 dana;
- Faza pismenog testa 10 dana nakon faze verifikacije;
- Faza intervju do 7 dana nakon objavljivanja rezultata pismenog testa;
- Objavljivanje rezultata do 5 dana nakon ocenjivanja intervju.

Beleška: Aplikacije koje pristignu nakon roka utvrđenog u konkursu i one nepotpune sa odgovarajućom dokumentacijom neće se razmatrati.


Način ocenjivanja i kriterijumi bodovanja:

- Ocenjivanje kandidata se odvija putem pismenog testiranja i intervjuisanja (usmeno testiranje);
- Pismeni test - maksimalno 70 bodova;
- Intervju - maksimalno 20 bodova;
- Životopis - maksimalno 10 bodova.

Lekarska komora Kosova pruža jednake mogućnosti zapošljavanja za sve državljane Republike Kosova i pozdravlja aplikacije od sva lica muškog ili ženskog pola i svih zajednica u Republici Kosovo.

Oglas je otvoren od dana 18.04.2025 deri më 05.05.2025 u 23:59 časova.

Za detaljnije informacije možete kontaktirati na br. tel.:049/872-300 ili 038/544-872.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook  www.facebook.com/gjejpuneshpejte


RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISHTINË



Lume's Details

Estetik & Depilim

 044 900 978 | 045 687 898

 Sallon Depilimi Lume's Details

 lumesdetails

 Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Erëblina Zymberi shpall të pavlefshme dëftesën e kl. 10 të sh.m.Mjekësisë “Hysni Zajmi” Gjakovë.
- Marie Prenkaj shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12.13 dhe diplomën e sh.m. Mjekësisë “Hysni Zajmi” Gjakovë.
- Dijon Krasniqi shpall te pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën QK “11 Marsi” Prizren.
- Valentin Perdedaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu “ Pjeter Budi “ Lubizhde e Hasit.
- Jeton Perdedaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu “ Pheter Budi “ Lubizhde e Hasit.
- Sadije Berisha shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu “ Fadil Hisari “ Prizren.
- Venera Qollaku shpall të pavlefshme 4 dëftesat dhe diplomën e shkollës së mesme “Luciano Motroni” Prizren.
- Alnor Boshnjaku shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën e sh.m. Mjekësisë “Hysni Zajmi” Gjakovë.
- Saime Muhaxhiri B.I. nga Gjakova të numrit fiskal 810246331 të lëshuar nga ARBK.
- Shpresa Krasniqi shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të sh.f.m.u. “Kongresi i Manastirit” Damjan Gjakovë. Nga kl 1-8
- Fatlinda Fazlija shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.
- Resmije Kryeziu shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 1.2.3.4 dhe diplomën e sh.m. Mjekësisë “Hysni Zajmi” Gjakovë.
- Nikë Deda shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 1.2 të Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, bane- sa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipër- faqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 400 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)
- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.
- Lëshoj banesën një dhomshe me qira, ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.
- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992





ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1900

Columbus, Georgia, USA
0.5L